

VENDIM
Nr. 243, datë 21.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ES 2019” SHPK
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 8, pika 3, neni 9, pikat 1,2,3, pika 4,8, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/13 prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘ES 2019’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ES 2019” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1239 prot., datë 2.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “ES 2019” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim:

- Neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “d”, plotësuar;

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

- Neni 9, pika 2:

- gjerat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/i veçantë nga akti i themelimit)), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE aktin e themelimit të nënshkruar nga themeluesi (origjinal ose fotokopje e noterizuar), si dhe statutin në formatin origjinal ose fotokopje e noterizuar;

- germa “c” (vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit;

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata), plotësuar pjesërisht;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Neni 9, pika 3

- germa “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera, paraqitja e bilancit të këtyre të fundit), pa plotësuar;

- Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar në ERE dokumentacionin që kërkohet nga kjo pikë e rregullores;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike:

Neni 9, pika 4.8

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh sipas viteve). Plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, shoqëria ka deklaruar volumin e tregtimit të energjisë për një vit, ndaj duhet të saktësojë sasinë e energjisë që parashikon edhe për 4 vitet e tjera;

- germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.) Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- germa “c” (Lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka pasur)). Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar informacion qoftë edhe në mënyrë deklarative në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, do të njoftohet subjekti t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti